



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 11 Shkurt 2021

Nr: 62

**VENDIM**

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR REGJISTRIMIN E KOMITETIT NISMËTAR QË DO TË ORGANIZOJË PUNËN PËR PARAQITJEN E Z. DRAGUA CEKA SI KANDIDAT I PROPOZUAR NGA ZGJEDHËSIT NË ZONËN ZGJEDHORE QARKU TIRANË, NË ZGJEDHJET PËR KUVENDIN TË DATËS 25 PRILL 2021**

Në mbështetje të neneve 19, pika 1, shkronja “n”, 2 e 69, pikat 1 e 3 të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pasi shqyrtova kërkesën e depozituar nga komiteti nismëtar për regjistrim, i cili do të organizojë punën për paraqitjen e z. Dragua Ceka si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin, që do të zhvillohen në datën 25 Prill 2021,

**V Ë R E J**

Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 65, pikat 1 e 2, e 92 shkronja “gj”, e 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 8, 9, pikat 1 e 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin.

Bazuar në përcaktimet e nenit 69, “Kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për zgjedhjet në Kuvend”, komiteti nismëtar i përberë nga, z. Sinan Qazim Boka, z. Ali Sadik Sadiku, z. Shkëlqim Tomorr Kalemi, z. Aldo Tahir Kalemaj, z. Pullumb Skënder Boka, z. Altin Sadik Sadiku, zj. Liri Selim Kalemi, z. Pajtim Sinan Mata, z. Shkëlqim Sami Flaga, i janë drejtuar KQZ-së me kërkesë për regjistrimin e komitetit nismëtar të formuar prej tyre. Kërkesa e paraqitur prej tyre është administruar me nr. 997 prot., datë 08.02.2021.

Kërkuesit e kanë paraqitur kërkesën e tyre duke depozituar emrat dhe nënshkrimet e tyre në të, si dhe i kanë bashkëlidhur kërkesës kopjet e dokumenteve të identifikimit.



Data: 11 Shkurt 2021

Nr: 62

**Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e komitetit nismëtar që do të organizojë punën për paraqitjen e z. Dragua Ceka, i propozuar nga zgjedhësit në qarkun Tiranë, për zgjedhjet në Kuvendin të datës 25 Prill 2021**

Kërkuesit janë zgjedhës të zonës zgjedhore qarku Tiranë dhe me vullnet të lirë kanë vendosur krijimin e komitetit nismëtar për organizimin e punës për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin z. Dragua Ceka.

Nga verifikimi i emrave të kërkuesve në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë rezulton se, 9 anëtarët e komitetit nismëtar rezultojnë si zgjedhës në zonën zgjedhore qarku Tiranë.

Pas verifikimeve përkatëse konstatoj se, kërkesa e paraqitur prej këtyre zgjedhësve respekton kriterin e afatin e përcaktuar në nenin 69 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, gjithashtu respekton edhe pikën 3 të nenit 69 që parashikon së grupi nismëtar krijohet nga jo më pak se 9 zgjedhës nga zona zgjedhore që do paraqesin kandidatin.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pika 1 shkronja “n”, 2 e 69, pika 3, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar,

### **V E N D O S :**

1. Regjistrimin e komitetit nismëtar që do të organizojë punën për paraqitjen e z. Dragua Ceka, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Qarku Tiranë, në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

